

## **Më kanë arrestuar - çfarë ndodh tani?**

Jeni arrestuar nga policia sipas nenit 36 të Ligjit mbi të Huajt e Konsoliduar (Udlændingeloven). Keni të drejtën e një avokati gjatë arrestimit. Vetëm avokati juaj është përgjegjës për interesat tuaja.

Padyshim që do të kërkonti përgjigjet e një numri pyetjesh, prandaj një numër avokatësh me përvojë kanë nxjerrë këtë broshurë, e cila shpjegon çfarë mund të bëjë avokati juaj kur mbaheni nën arrest sipas nenit 36 të Ligjit mbi të Huajt e Konsoliduar (Udlændingeloven).

### **Arrestimi**

Në kohën e arrestimit tuaj, policia do t'ju ketë dhënë një sqarim të shkurtër se pse jeni arrestuar. Policia do t'ju ketë këshilluar gjithashtu për të drejtën tuaj për të kontaktuar ambasadën ose konsullatën e vendit tuaj. Nëse kërkonti azil, keni gjithashtu të drejtën për të kontaktuar Këshillin Danez të Refugjatëve. Për më tepër, policia do t'ju ketë këshilluar para se të paraqiteshit në gjyq të paktën 3 x 24 orë pas momentit në kohë kur ju arrestuan. Para daljes në gjyq, gjykatësi do të sigurojë që ju kanë caktuar një avokat.

Gjatë daljes në gjyq, gjykatësi do të vendosë nëse duhet të vazhdoni të mbeteni nën arrest, apo nëse duhet të liroheni.

### **Përdorimi i avokatit tuaj**

Avokati juaj mund t'ju ndihmojë kur policia merret me çështjen tuaj. Mund të merrni ndihmë për një numër të madh pyetjesh të rëndësishme kur çështja është në vazhdim. Vlen të dihet se për çfarë mund ta përdorni avokatin:

- Detyra e avokatit

Është detyra e avokatit të kujdeset për interesat tuaja gjatë arrestimit, përfshirë edhe garantimin - me ndihmën tuaj - që mbaheni të arrestuar për kohën më të shkurtër të mundshme.

- Trajtimi i çështjes nga autoritetet

Janë autoritetet e emigracionit, të cilat vendosin nëse keni të drejtë të banoni apo punoni në Danimarkë. Policia do të kryejë hetimet e nevojshme që çështja juaj të gjykohej. Keni detyrimin t'i përgjigjeni pyetjeve të bëra, por mund të kërkonti praninë e avokatit tuaj gjatë marrjes në pyetje. Shërbimi Danez i Emigracionit, Prokuroria Publike dhe Shërbimi Danez i Sigurisë dhe Inteligjencës mund të shkëmbejnë informacion rreth jush, nëse ka lidhje me rastin tuaj ose është në interes të sigurisë kombëtare.

- Intervista konfidenciale

Avokatit tuaj nuk i lejohet t'i bëjë të ditur ato çfarë keni diskutuar, policisë apo çdokujt tjetër. Me fjalë të tjera, marrjet në pyetje janë konfidenciale. Avokati juaj mund t'i tregojë dikujt tjetër vetëm se çfarë keni rënë dakord për të diskutuar. Nëse gjatë takimeve tuaja me avokatin është i pranishëm përkthyesi, po njësoj edhe atij nuk i lejohet t'i bëjë të ditur askujt se çfarë keni thënë.

## **Zgjedhja e avokatit**

Mund të zgjidhni personalisht se kë dëshironi t'ju përfaqësojë. Nëse dëshironi të ndryshoni avokatin, mund t'i shkruani avokatit që do të dëshironit t'ju përfaqësojë. Përndryshe, mund t'i shkruani gjykatës ose policisë. Mund të pyesni stafin e burgut t'ju ndihmojë të gjeni adresën e saktë.

## **Pagesa e avokatit tuaj**

Gjykata do t'ju caktojë një avokat, pavarësisht nëse e keni kërkuar ju apo gjykata. Tarifa e avokatit paguhet nga shteti. Prandaj nuk pse të paguani për përfaqësimin ligjor.

## **E drejta për përkthyes**

Kur dilni para gjykatës, kur merreni në pyetje nga policia apo keni një takim me avokatin, keni të drejtën e një përkthyesi. Është e rëndësishme të thoni menjëherë, nëse keni vështirësi për të kuptuar përkthyesin apo mendoni në një farë mënyre se përkthimi po shkakton probleme. Edhe përkthyesi paguhet nga shteti.

## **Vizitat dhe letrat**

Keni të drejtën për të pritur vizitorë, si dhe të dërgoni dhe merrni letra. Në rrethana të caktuara policia mund të vendosë që nuk duhet të pranoni vizita nga persona të caktuar apo të kërkojë që vizitat tuaja të mbikëqyren. Këto vendime mund të paraqiten në gjykatë. Gjithashtu policia mund të kontrollojë letrat tuaja para se t'i merrni apo dërgoni ato, dhe në rrethana të veçanta mund t'ju mbajë ato. Çdo vendim i policisë për t'ju mbajtur letrat duhet të paraqitet në gjykatë.

Ju gjithmonë keni të drejtën e një kontakti të pambikëqyrur me avokatin tuaj.

## **Arrestimi - maksimumi nga 4 javë**

Mund të mbaheni i arrestuar maksimumi nga 4 javë. Kur mbaron afati i fundit, gjykatësi do të ekzaminojë nëse ka akoma baza të arsyeshme për arrestimin tuaj. Ky vendim merret në një seancë të shkurtër dëgjimore, gjatë të cilës keni të drejtën të jeni të pranishëm. Megjithatë, seanca dëgjimore mund të kryhet gjithashtu në mënyrë që ju dhe përfaqësuesi juaj ligjor të flisni para gjykatësit dhe akuzës me ndihmën e telekomunikimit audio-vizual.

Avokati juaj mund të japë prova për lirimin tuaj dhe të kundërshtojë. Në anën tjetër, policia duhet të sigurojë arsye, nëse duan të vazhdojnë t'ju mbajnë nën arrest.

Gjykatësit i lejohet të zgjasë arrestimin maksimumi nga katër javë. Pas kësaj kohe, duhet të paraqiteni sërish para një gjykatësi, i cili do të vendosë nëse duhet të vazhdoni apo të mbeteni nën arrest. Prandaj, nuk mund të mbështeteni në lirimin tuaj pas përfundimit të periudhës 4-javore. Megjithatë, ju keni të drejtën të dëgjoheni nga një gjykatës në fund të periudhës 4-javore të arrestimit.

Arrestimi nuk duhet të jetë tejet i gjatë dhe normalisht nuk duhet të kalojë 6 muaj.

Nëse Gjykata e Rrethit nuk ju liron, mund ta çoni çështjen në Gjykatën e Lartë, e cila gjithashtu mund të përcaktojë nëse duhet të liroheni apo jo. Gjykata e Lartë jep vendimin e saj bazuar në një çështje të shkruar, me fjalë të tjera, pa pasur mundësinë që ju dhe avokati juaj të flisni me gjykatësin.

## **Zgjatja e vullnetshme - maksimumi 2 ose 4 javë**

Kur periudha e arrestimit është pranë mbarimit të afatit, së bashku me avokatin, mund të vendosni nëse vullnetarisht pranoni një zgjatje të arrestimit prej 2 ose 4 javë.

Kjo realizohet me një kërkesë me shkrim drejtuar gjykatës nga avokati juaj ku shprehet pëlqimi për një zgjatje të vullnetshme të afatit. Kjo do të thotë se nuk keni pse të paraqiteni në gjykatë.

### **Paraqitja në ambasadë ose konsullatë**

Policia mund të përcaktojë nëse duhet të takoheni me ambasadën ose konsullatën e vendit tuaj apo të çdo vendi tjetër me qëllim përcaktimin e identitetit tuaj ose lëshimin e dokumenteve të udhëtimit. Nëse kundërshtoni takimin me ambasadën apo konsullatën, mund të kërkonti që policia të paraqesë pyetjet në gjykatë, në mënyrë që ata të përcaktojnë nëse ju kërkohet të lini takim.

### **Jeni në dyshim?**

Jo gjithmonë është e mundur që avokati juaj t'ju thotë se kur ai apo ajo mund të vijë t'ju takojnë. Prandaj mund të jetë një ide e mirë t'i shkruani pyetjet, që t'ia jepni avokatit kur ta takoni herën e ardhshme.

Nëse nuk jeni të sigurt apo jeni në dyshim për ndonjë gjë tjetër të çështjes tuaj, gjithmonë keni të drejtën të kontaktoni avokatin tuaj.